



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Enke Blomj

Nr. 376/3 Prot.

Vlorë më 22.02.2019

VENDIM
Nr. 8, datë 22.02.2019

U

PËR
PËRCAKTIMIN E MASËS E SHPËRBLIMIT FINANCIAR TË ANËTARËVE TË
BORDIT TË ADMINISTRIMIT DHE SENATIT AKADEMIK

Mbështetur në neni 49 pika 1, gërma a,ë, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" VKM-së nr.329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", neni 18, dhe Vendimin nr. 656, datë 31. 10. 2018, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të Qeverisjes Qëndrore" pika 5, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 22.02.2019

VENDOSI

1. Masa e shpërblimit mujor për Kryetarin e Senatit Akademik të jetë 25.000 (njëzetë e pesë mijë) lekë.
2. Masa e shpërblimit mujor për anëtarët e Senatit Akademik të jetë 23.000 (njëzetë e tre mijë) lekë.
3. Masa e shpërblimit mujor për Kryetarin dhe Anëtarët e Bordit të Administrimit të jetë 25.000 (njëzetë e pesë mijë) lekë.
4. Masa e shpërblimit mujor për Sekretarin e Bordit të Administrimit për punën në mbështetje të aktivitetit të Bordit të Administrimit të jetë 10.000 (dhjetë mijë) lekë. Ky shpërblim t'i shtohet pagës mujore që ai përfiton në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë
5. Anëtarëve të Bordit të Administrimit si dhe Sekretarit, të cilët udhëtojnë Brenda ose jashtë vendit të tyre të punës për mbledhjet e Bordit t'u rimburohen shpenzimet e udhëtimit, fjetjes si dhe trajtime të tjera (dieta, hotel, bileta etj)
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë
7. Çdo vendim i mëparshëm shfuqizohet.
8. Ky vendim hyn në fuqi nga 1 Mars 2019.

[Signature]

Adresa /Address: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Ëeb-site: ees.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



[Signatures]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Dr.Rezana Vrapit- Kryetare

Florian Nurce- Anëtar

Ornela Koleka- Anëtar

Dr. Elsajed Rexhaj- Anëtar

Dr. Enida Pulaj- Anëtar

Dr. Marinela Muço- Anëtar



Gentiana Belulaj

Adresa /Address: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Ëeb-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

VENDIM

Nr. 656, datë 31.10.2018

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bordet, këshillat, komitetet dhe komisionet e përhershme të njësive të qeverisjes qendrore, që këtu e në vijim emërtohen organe kolegjiale, përbëhen nga përfaqësues të njësive të qeverisjes qendrore dhe nga përfaqësues të tjerë, sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës. Përfaqësues i njësisë së qeverisjes qendrore në këto organe emërohet punonjësi organik i njësisë. Punonjësit e emëruar në përbërje të organeve kolegjiale përfitojnë një pagesë për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në këto organe, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Nuk janë objekt i këtij vendimi organet drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve kushtetuese dhe të pavarura, që funksionojnë si të tilla sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", si dhe të institucioneve që nuk financohen nga buxheti i shtetit.

3. Emërtesa e çdo organi kolegjial, numri i anëtarëve në përbërje të tyre, numri maksimal i pagesave në një vit, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera, si dhe masa e pagesës së tyre, përcaktohen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Masa e shpërblimit të punonjësve të emëruar në komisionet e mëposhtme është, si më poshtë vijon:

a) Për komisionet e posaçme të shpronësimit të ngritura në njësitë publike, masa e shpërblimit të anëtarëve në përbërje të tyre, është 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo vendim shpronësimi të

miratuar;

b) Për komitetin e auditimit të ngritur në njësitë publike, masa e shpërblimit të tre anëtarëve, është 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo mbledhje, por jo më shumë se 4 pagesa në vit;

c) Për Komisionin e Përhershëm të Vlerësimit të Objekteve të Trashëgimisë Kulturore, masa e shpërblimit është 5 000 (pesë mijë) lekë secili prej anëtarëve, për çdo akt vlerësimi;

c) Për komisionin rajonal mjekësor për caktimin e aftësisë për punë, në varësi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, masa e shpërblimit është 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj për kryetarin dhe 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për anëtarin, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera në një muaj;

d) Për Komisionin Epror Mjekësor për Caktimin e Aftësisë për Punë, në varësi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, masa e shpërblimit është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj për kryetarin dhe 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj për anëtarin, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera në një muaj;

dh) Për Komisionin Mjekësor Qendror për Përcaktimin e Verbërisë, në varësi të Shërbimit Social Shtetëror, masa e shpërblimit është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj për kryetarin dhe 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj për anëtarin, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera në një muaj;

e) Për komisionin e posaçëm për miratimin e materialeve të përkthyer të legjislacionit të Bashkimit Evropian në shqip, pranë ministritë përgjegjëse për Evropën, masa e shpërblimit të anëtarëve në përbërje të tij përcaktohet sipas kriterëve të udhëzimit të përbashkët të ministrit përgjegjës për Evropën dhe ministrit përgjegjës për financat dhe ekonominë.

5. Kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në senatin akademik dhe bordin e administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.

6. Përfshihen nga e drejta e pagesës sipas pikës 3, të këtij vendimi, punonjësit e emëruar si përfaqësues të institucionit në më shumë se 2 (dy) nga organet kolegjiale të përcaktuara në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Shpenzimet për kryerjen e pagesës së punonjësve në përbërje të organeve kolegjiale, të cilat vërtetohen kundrejt dokumentit të pjesëmarrjes në mbledhje, si dhe çdo shpenzim

tjetër i natyrës operative (jo shpërblim), të kryer për realizimin e detyrave të organeve kolegjiale, përballohen nga institucionet e ngarkuara për krijimin e organeve kolegjiale, brenda buxhetit vjetor të tyre.

8. Njësia e qeverisjes qendrore që emëron përfaqësues të saj në organet e ndryshme kolegjiale, ka detyrimin e mbajtjes së të dhënave të angazhimit të punonjësve të saj në këto organe.

9. Efektet financiare për organet kolegjiale që rregullohen për herë të parë me këtë vendim, fillojnë nga momenti i funksionimit të tyre dhe përballohen nga buxheti i miratuar për institucionet përkatëse, të përmendura në vendim.

10. Vendimi nr. 418, datë 27.6.2012, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore", shfuqizohet.

11. Ngarkohen njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Emertesa e Bordit/Keshillit/Komisjonit	Numri maksimal i pagesave ne nje vit	Perberja		Masa e shperblimit ne Leka	
		Kryetari	Nr. i Anetareve	Kryetari	Anetari
Keshilli Rregullimit Teritorit ne RSH	6	1	12	20,000	20,000
Komiteti Kombetar i Digave te Medha	12	1	10	20,000	20,000
Keshilli Teknik i Perhershem i Digave	6	1	4	20,000	20,000
Bordi Menaxhimit te Autoritetit Rrugor Shqiptar	12	1	6	15,000	12,000
Komisioni i dhënies së Licensave Profesionale ne fushen e studimit e projektimit dhe mbikqyrjes e kolaudimit (ne fushen e ndertimit)	12	1	10	8,000	7,000
Komisioni i dhënies së Licensave Profesionale ne fushen e vleresimit te Pasurive te Paluajtshme	12	1	6	8,000	7,000
Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatoreve	6	1	4	5,000	5,000
Komisioni i Ndihmes Shtetërore	6	1	4	10,000	10,000
Bordi i Kontrollit te Brendshem Financiar Publik	4	1	7	20,000	15,000
Komisioni i kualifikimit te audituesve te brendshem	12	1	4	8,000	7,000
Bordi i Mbiqyrjes Publike	12	1	6	20,000	20,000
Keshilli i Larte i Arsimit dhe Shkences	6	1	18	20,000	15,000
Keshilli Kombetar i Arsimit Parauniversitar	6	1	6	13,000	13,000
Komisioni i Larte i Sportit	6	1	8	5,000	5,000
Keshilli Kombetar Kunder Dhunes ne Sport	6	1	8	5,000	5,000
Komisioni Antidoping	6	1	9	5,000	5,000
Keshilli Kombetar per te Drejten e Autorit	5	1	4	5,000	5,000
Keshilli Shkencor i Bibliotekes Kombetare	4	1	7	5,000	5,000
Bordi artistik i Teatrit Kombetar te Opera/Baletit/Asamble popullore	4	1	6	5,000	5,000
Bordi Artistik i Teatrit Kombetar	4	1	6	5,000	5,000
Bordi artistik i Galerise Kombetare	4	1	6	5,000	5,000
Bordi Artistik i Qendres Kombetare per Fëmijë	4	1	6	5,000	5,000
Bordi Artistik i Arkivit Qendror te Filmit	4	1	6	5,000	5,000
Bordi Artistik i Teatrit Kombetar Eksperimental "Kujtim Spahivogli"	4	1	6	5,000	5,000
Bordi Artistik i Cirkut Kombetar	4	1	6	5,000	5,000
Keshilli Kombetar i Arkeologjise	4	1	4	5,000	5,000
Komiteti Kombetar i Trashegimise Kulturore Shpirtërore	4	1	6	5,000	5,000
Keshilli i Akreditimit te institucioneve shendetesore	4	1	5	20,000	15,000
Komisioni i mbrojtjes nga njezartimi	4	1	4	10,000	10,000
Komiteti Shtetëror per Planifikimin Sptalor	4	1	10	5,000	5,000
Komiteti Kombetar i Transfuzionit te Gjakut	2	1	13	5,000	5,000
Bordi i Edukimit te Vazhdueshem ne fushen e shërbimit	8	1	8	7,000	7,000
Komisioni i Çmimit te Barnave	12	1	6	7,000	7,000
Komiteti Ndërsëktorial për Mbrojtjen nga Produktet e Duhant (KIMSHPD)	12	1	7	5,000	5,000
Komiteti i Etikës (ne fushen e barnave dhe farmaceutikes)	12	1	9	15,000	15,000
Keshilli Drejtues i Komitetit Shqiptar te Biresimeve	12	1	9	10,000	10,000
Komisioni vleresimit te programit mbrojtjes se dashmitareve/bashkepunetoreve te drejtësisë	12	1	4	20,000	15,000
Keshilli i Larte i Arkivave (prane D.P Arkivave)	4	1	17	10,000	5,000
Komisioni Qendror i Ekspertizes (prane D.P Arkivave)	4	1	15	5,000	5,000
Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvleresimit te Informacionit te Klasifikuar "Sekret shtetëror" (prane D.P Arkivave)	4	1	5	5,000	5,000
Komisioni i Perhershem i Ekspertizave te Vleresimit te dokumentave me rendesi historike kombetare (prane D.P Arkivave)	4	1	9	5,000	5,000
Keshilli i Statistikave	6	1	10	20,000	12,000
Komisioni Kombetar i Nomenklatures	3	1	18	10,000	8,000
Keshilli Drejtues i Shkolles së Magistratures	6	1	17	10,000	10,000
Keshilli Pedagogjik i Shkolles së Magistratures	2	1	15	8,000	8,000
Bordi i Redakteve i Shkolles së Magistratures	6	1	9	8,000	8,000
Keshilla miratues i projekteve te filmit artistik	3	1	5	20,000	20,000
Keshilla miratues i projekteve te filmit dokumentar	3	1	5	15,000	15,000
Keshilla miratues i projekteve te filmit vizatimor	3	1	5	15,000	15,000
Komisioni i Vizionimit	3	1	2	8,000	8,000
Komisioni Financiar i filmit artistik	3	1	3	15,000	15,000
Komisioni Financiar i filmit vizatimor	3	1	3	8,000	8,000
Komisioni Financiar i filmit dokumentar	3	1	3	8,000	8,000
Bordi Drejtues i Keshillit Kombetar Kontabilitetit	12	1	8	20,000	15,000
Bordi Mbiqyrjes i AMSHC	9	1	8	7,000	5,000
Bordi drejtues i Instituti i studimeve per Krimet dhe Pasojat e Komunizmit	9	1	6	20,000	20,000
Keshilli Shkencor i Instituti i studimeve per Krimet dhe Pasojat e Komunizmit	6	1	6	15,000	15,000
Keshilli i Botimeve prane Akademise se Shkencave	3	1	12	5,000	5,000
Keshilli Nder-akademik per Gjuhen Shqipe prane Akademise se Shkencave	3	1	12	5,000	5,000
Keshilli Drejtues i Agjencise se Ofimit te Sherbimeve Publike te Integrues	8	1	6	20,000	20,000
Keshilli Koordinues i Botimeve per Diasporën	6	1	4	5,000	5,000
Keshilli Drejtues i Agjencise Kombetare per Diasporën	6	1	7	15,000	15,000
Keshilli Mbiqyrjes i Agjencise Auditimit te Programeve te Asistences	9	1	2	10,000	10,000